



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMI I KURRIKULËS BËRTHAMË PËR SHKOLLAT E MESME TË  
GJUHËVE TË HUAJA**

**FUSHA: GJUHË E HUAJ**

**LËNDA: ITALISHT**

**KODI:3.4.11.B**

**PROGRAMI I LËNDËS  
ITALISHT  
PËR KLASËN E 11-të**

**Koordinatori: ERIFILI HASHORVA**

**Redaktori:GAZMEND KRASNIQI**

**Përgjegjës sektori:MARITA HAMZA**

**TIRANË, KORRIK 2010**

Mësimdhënia e gjuhës italiane në shkollën e mesme është një tjetër ndihmesë që kurrikula për shkollat e mesme i jep formimit dhe aftësimin të përgjithshëm të nxënësit, duke i dhënë atij mjetet e duhura për të përballuar situata të ndryshme brenda dhe jashtë bankave të shkollës. Ajo ndihmon në mundësitë shprehëse që ai ka në dispozicion si dhe e pajis atë me mjetet dhe me metodologjitë e përshtatshme për të komunikuar në kontekste të ndryshme.

Programi i hartuar në vijim pasqyron sygjerimet e Kurrikulës Kombëtare për gjuhëst e huaja ashtu edhe udhëzimet e Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave të Këshillit të Evropës.

Objektivi themelor që përmban mësimi i gjuhës italiane në klasën e 11-të i lidhur me nivelin gjuhësor që nxënësi duhet të arrijë në këtë klasë, niveli B1<sup>+</sup> sipas KPER, mbetet ai sipas të cilit mësuesi duhet të ndihmojë nxënësin duke e orientuar atë drejt aftësimin dhe të menduarit në një gjuhë të huaj pa patur nevojë që të përkthejë në gjuhën e tij. Realizimi i këtij objektivi mundësohet përmes përvetësimit sa më të mirë të strukturave gjuhësore, leksikore dhe komunikuese e kulturore.

Niveli B1<sup>+</sup> i korrespondon një shkalle më të lartë se Niveli prag B1. Aty gjenden po ato dy karakteristika dhe shtohen një numër përshkruesish që përqëndrohen në sasinë e informacionit të shkëmbyer, për shembull: merr mesazhe për kërkesa informacioni dhe shpjegon një vështirësi; sjell informacion konkret që i kërkohet në një bisedë apo në një konsultim (si përshkrimi i simptomave të një mjeku) por me një saktësi të kufizuar, shpjegon përse diçka përbën problem; shpreh opinionin e tij mbi një lajm, një artikull, një parashtrim, një diskutim, një bisedë, një dokumentar dhe u përgjigjet pyetjeve mbi hollësi të mëtejshme- bën përmbledhjen e tyre; zhvillon një bisedë të organizuar duke verifikuar dhe konfirmuar informacionin, madje duke e bërë bashkëfolësin të përsërisë herë pas here në rastet kur përgjigja është e gjatë dhe e dhënë me shpejtësi; përshkruan se si bëhet diçka dhe jep udhëzime të hollësishme; shkëmben me një farë sigurie një sasi të madhe informacionesh faktike mbi çështje të zakonshme ose që nuk i përkasin fushës së tij.

Nxënësi mëson:

- të përvetësojë strategji të të nxënit në gjuhën italiane të shkruar dhe të folur,
- të njohë fakte kulturore mbi Italinë,
- të zhvillojë strategji të të nxënit individual për përforsimin e aftësive gjuhësore që mundësojnë vazhdimisht studimin e gjuhës italiane si me gojë dhe me shkrim.

## **1. SYNIMI I LËNDËS**

Përmes mësimin të gjuhës italiane në klasën e 11-të synohet:

- zhvillimi i katër aftësive bazë, (të kuptuarit dhe të shprehurit me gojë, të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim) duke i dhënë përparësi zhvillimit të kompetencës gjuhësore dhe komunikuese.

## 2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim te klasës se 11-të nxënësi,-ja duhet:

- të komunikojë saktë me shkrim dhe me gojë,
- të lidhë situata gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale.
- të përballojë me shkathtësi problemet e përditshme përmes formimit të tij/saj gjuhësor.
- të bëjë dallimin midis kulturave të ndryshme.

## 3. OBJEKTIVAT

### a) Objektiva sipas standardit në komunikim

*Pershkrimi:* Këto objektiva propozohen si ndihma nga ana e mësuesit për nxënësin në mënyrë që ai/ajo të mund të komunikojë me efektivitet si dhe të mund të menaxhojë një sërë situatash të ndryshme, në veçanti ato me karakter formal dhe akademik, duke pasuruar fjalorin e tij/saj si dhe llojshmërinë e vështirësinë e strukturave të përdorura.

	<b>Objektiva</b>
<b>Komunikimi dhe Veprimtaritë në komunikim</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• të shprehet lirshëm për probleme ose çështje të ndryshme.</li><li>• të shprehë ndjenja si: dashuri, urrejtje, vlerësim, mosvlerësim, miratim, mosmiratim, gëzim, dëshirë, etj.</li><li>• të ngrejë hipoteza reale dhe të mundshme.</li><li>• të shprehet qartë dhe saktë në situata formale e jo formale.</li><li>• të flasë në vija të përgjithshme mbi intrigën e një filmi apo libri.</li><li>• të protestojë me shkrim mbi një padrejtësi që i është bërë duke renditur arsyet e tij.</li><li>• të përballojë dhe të kryesojë një bashkëbisedim edhe pse me pak vështirësi.</li><li>• të kërkojë dhe të zbatojë informacione të hollësishme.</li><li>• të realizojë me sukses një intervistë të parapërgatitur duke verifikuar e konfirmuar informacionet edhe nëse do të kishte nevojë për përsëritje të argumentit.</li></ul>

### b) Objektiva sipas standardit në Kulturë.

*Pershkrimi:* Objektivat sipas standartit në kulturë propozohen si ndihma për nxënësin që të zhvillojë njohuritë e tij mbi vendin dhe gjuhëfolësit e gjuhës që po studion, në mënyrë që ai

pasi të marrë njohuritë e duhura dhe që përmban lënda vjetore të mundë të ecë dhe të zotërojë situata të ndryshme komunikuese.

	<b>Objektiva</b>
<b>Kulturë</b>	<p><b>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të ndjekë informacione të ndryshme (shtypi, televizioni, media të tjera, interneti...)</li> <li>• të flasë mbi kohën e lirë, organizimin e saj, domethënien e saj.</li> <li>• të flasë e të krahasojë peisazhin natyror, mes dy vendeve.</li> <li>• të ketë njohuri mbi organizimin social-politik-kulturor (në linja të përgjithshme, ngjasime dhe ndryshime).</li> <li>• të japë e të marrë këshilla në fushën ekonomike (në linja të përgjithshme).</li> <li>• të dijë të japë të dhëna mbi të shkuarën dhe të tashmen.</li> <li>• të trajtojë tema kulturore që kanë të bëjnë me : <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ popullsinë (origjina dhe përbërja e saj)</li> <li>✓ punën</li> <li>✓ raportet familjare</li> <li>✓ jetën shkollore</li> <li>✓ botën rinore</li> <li>✓ zakonet në të ushqyer</li> <li>✓ traditat</li> <li>✓ festat e ndryshme fetare e zyrtare</li> </ul> </li> <li>• të ketë njohuri dhe të marrë pjesë në diskutime mbi personazhe të njohur të artit, kulturës, kinematografisë italiane.</li> <li>• të ketë njohuri mbi profesionet tradicionale dhe moderne si në vendin ku flitet gjuha në studim, si dhe krahasimi mes tyre dhe profesioneve në vendin e tij.</li> <li>• të përshkruajë një ëndërr, një shpresë apo një qëllim.</li> <li>• të japë shpjegime të shkurtra rreth një opinioni të tij apo rreth një projekti.</li> </ul>

**c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor.**

**Përshkrimi:** Objektivat e standardit në formimin gjuhësor të nxënësit shërbejnë si pika referimi për mësuesin mbi elementët gramatikorë me të cilët do të haset nxënësi gjatë vitit shkollor. Elementë që janë thellim dhe përforcimi i elementëve të marrë në vitet e mëparshme të studimit, për të riparë me një sy më të thellë dhe elementë që mund të analizohen vetëm në këtë nivel studimi sipas KPER.

	<b>Objektiva</b>
<b>Strukturën gjuhësore</b>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet të përdore në mënyrë të saktë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ morfologjinë dhe sintaksën</li> <li>➤ format tipike në gjuhën e shkruar-formale për të përshëndetur, pyetur, ftuar, falënderuar, për të kërkuar ndjesë</li> <li>➤ nocione mbi ligjëratën e drejtë</li> <li>➤ disa forma më të ndërlikuara për të shprehur gjykime, mendime etj</li> <li>➤ disa forma gjuhësore për të shprehur në gjuhën formale, raportin shkak-pasojë</li> <li>➤ format gjuhësore për të shprehur në gjuhë formale kushtet e të qenit</li> <li>➤ disa forma gjuhësore për të shprehur në gjuhë formale, raportin kundërshtim/lejim</li> <li>➤ struktura të fjalisë dhe mekanizma formale të thjeshta në disa tipe tekstesh</li> </ul> <p><b>Gjithashtu nxënësi aftësohet të përdorë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ kohën e pakryer dhe të kryer</li> <li>➤ pjesëzat përemërore</li> <li>➤ përputhjen mes përemrit dhe pjesores</li> <li>➤ shkallët e mbiemrit</li> <li>➤ të ardhmen e thjeshtë dhe të përbërë</li> <li>➤ foljet pavetore</li> <li>➤ urdhëroren e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë me përemra.</li> <li>➤ foljet vetvetore</li> <li>➤ mënyrën kushtore (e tashme dhe e shkuar)</li> <li>➤ mënyrën lidhore</li> <li>➤ përputhjen e kohëve në mënyrën lidhore</li> </ul>

#### **4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSISË GJUHËSORE**

##### **TË DËGJUARIT**

Nxënësi është në gjendje të:

- kuptojë një diskutim të qartë, jo të tej zgatur apo me detaje të shumta mbi argumente të jetës së përditshme apo që kanë të bëjnë me studimin,
- kuptojë thelbin e shumë emisioneve televizive apo radiofonike mbi argumente të aktualitetit apo mbi tema që përbëjnë interes në jetën e tij personale, në gjuhën standarde,

- riprodhojë një tekst të thjeshtë me shkrim/me gojë dhe të modifikojë regjistrin e tij gjuhësor,
- kuptojë material informues audio të regjistruar apo i transmetuar nëpërmjet radios, që trajton argumente në interesin e tij personal apo studimi,
- përdorë burime audio/video si faqet web apo teknologjitë e tjera si në planin shkollor ashtu dhe në atë privat (muzikë, ipod, youtube),
- kuptojë instruksione e detyra mesatarisht të ndërlikuara,
- ndjekë mesazhe telefonike të qartë dhe koherentë mbi argumente edhe jo familjare,
- kuptojë tekste të thjeshta si: përralla, poezi, tregime, telefilma, këngë, reklama, talk shoë (kuptimin e përgjithshëm të ndërhyrjeve të veçanta), dokumentarë mbi argumente të ditura. referojë, perifrazojë, përmbledhë një diskutim të dëgjuar (me gojë apo me shkrim).

## **TË FOLURIT**

Nxënësi është në gjendje të:

- përshkruajë në mënyrë të qartë dhe të artikuluar përvoja dhe ndodhi,
- prezantojë dhe motivojë projekte, ëndrra duke shprehur mendime personale, pëlqime, ndjenja,
- rrëfejë subjektin e një filmi apo libri dhe të përshkruajë mbresat që i ka lënë,
- prezantojë në publik një relacion të përgatitur prej tij,
- përballojë situata kur ai flet me një bashkëbisedues amëtar si në një vend të huaj ashtu edhe në vendin e tij,
- marrë pjesë në diskutime mbi tema të njohura prej tij pa nevojën e domosdoshme të një përgatitjeje paraprake, duke shprehur qartë një pikëpamje të tij,
- tregojë një histori edhe të trilluar, subjektin e një filmi apo të një libri duke e ndarë në sekuenca kohore,
- sintetizojë çfarë ka dëgjuar, lexuar apo parë,
- japë udhëzime, direktiva, përshkruajë procese të ndërlikuara edhe mbi argumente teknike por familjare për të,
- di të veprojë në situata jo të zakonshme (urgjenca, të pa parashikuara, aksidente),
- di të komentojë, të propozojë alternativa, të kritikojë me mirësjellje sipas kontekstit komunikues.

## **TË SHKRUARIT**

Nxënësi është në gjendje të:

- kuptojë tekste të shkruara mbi argumente që kanë të bëjnë me botën rinore dhe me interesat e tij,
- kuptojë me lehtësi përshkrime mbi ndodhi, ndjenja dhe dëshira, që përmbahen në letra personale, ku përdoret një gjuhë jo formale,
- shkruajë tekste mbi shumë argumente të ndryshme,

- të riprodhojë një tekst të thjeshtë gojor/të shkruar dhe të modifikojë regjistrin gjuhësor të tij,
- përdorë në krijimet me shkrim nivelet e regjistrat gjuhësorë të duhur,
- kontrollojë saktësinë dhe koherencën e teksteve të shkruara duke ndjekur një listë të dhënash të caktuara,
- projektojë dhe hartojë një curriculum vitae,
- kontrollojë strukturat sintaksore më të përdorshme si bashkërenditëse ashtu edhe nënrenditëse.

## 5. KËRKESA TË GJUHËS ITALIANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjuhët e huaja e ndihmojnë nxënësin edhe në afrimin e tij me lëndët e tjera. Kështu përfshirja në Kurrikulën Kombëtare të lëndëve si:

- - Historia e artit
- - Qytetaria
- - Teatri
- - Informatika
- -Trashëgimia kulturore

tregon se sa ndikon njohja e gjuhës së huaj në perceptimin që nxënësi krijon për botën që e rrethon dhe se sa ndihmon kjo e fundit në asimilimin e këtyre lëndëve të tjera.

Lënda Gjuha Italiane do të ketë si një nga synimet e saj të së ardhmes pikërisht përforcimin dhe zgjerimin e njohurive gjuhësore për ta shndërruar në mbështetje për studimin e disiplinave të tjera. Në kohën tonë vjelja e materialeve në gjuhën e huaj është bërë një domosdoshmëri për përplotësimin e detyrimeve të disiplinave të tjera. Në këtë mënyrë i gjithë formimi në gjuhën italiane mund të japë një ndihmesë të drejtpërdrejtë për të kuptuar, vjelur, përshtatur mendime, sugjerime, zgjidhje sipas kërkesave më bashkëkohore të shkollës në mënyrë sistematike dhe të arsyetuar.

Nëpërmjet studimit të gjuhës Italiane do mundim të edukojmë tek nxënësit një ndjeshmëri dhe edukatë më të lartë qytetare. Një gjë e tillë e nxit formimin individual të nxënësit dhe të klasës në tërësi. I pasuron ata me mendim dhe me një qëndrim të ri për realitetin dhe për kontekstin ku jetojnë e studiojnë.

Është një mënyrë e drejtpërdrejtë e qasje me kulturën e vendit fqinj, dhe siguron një njohje më të shpejtë dhe vlerësim po ashtu të mënyrës së sjelljes, të qëndrimit, dhe të arritjeve. I paraprin stabilizimit të një komunikimi më frytdhënës me gjuhën dhe kulturën italiane në përgjithësi.

Ky program mbështet ne dokumente të rëndësishme si:

- Kuadri i Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar
- Standardet e arritjes

## 6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

### Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha italiane në klasën e 11-të zhvillohet me 4 orë mësimore në javë dhe shpërndarja e orëve të planifikuara bëhet në bazë të standardeve dhe aftësive të përcaktuara. Përdoruesit e programit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilin standard dhe aftësi. Kjo do të thotë që kur mësuesi ndeshet me vështirësi të caktuara në përmbushjen e objektivave të kapitullit, ai ngadalëson hapin, por ai mund të ecë më shpejt në realizimin e objektivave, kur vë re se nxënësit provojnë me shkrim apo me gojë një përvetësim të kënaqshëm në gjuhën italiane. Afërsisht 70% e orëve mësimore përdoren për shtjellimin e njohurive të reja lëndore, dhe 30% e tyre përdoret për përpunimin e njohurive të marra.

### **36 x 4 orë = 144 orë vjetore**

Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e standardeve dhe aftësive brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht shpërndarjes së orëve.

**Komunikimi dhe formimi kulturor zë 90 orë**, të cilat ndahen: 65 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (nga të cilat 70% e tyre ose ndryshe 46 orë , do të jenë për trajtimin e lëndës së re kurse 30 % e tyre ose ndryshe 19 orë do të shërbejnë për përpunimin e tyre) dhe 25 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (nga të cilat 70% e tyre ose ndryshe 18 orë mësimore do të shërbejnë për njohuritë e reja kurse 30 % pra 7 orë mësimore do të përdoren për përpunimin e njohurive).

**Formimi gjuhësor zë 54 orë.** Janë kryesisht ore në të cilat mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore, gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre që përbëjnë 37 orë mësimore do të shfrytëzohen për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30 % e tyre që përbëjnë 17 orë do të shërbejnë për rimarrjen, për përpunimin dhe përforcimin e tyre).

## 7. VLERËSIMI

Nëse pedagogjia dhe praktikat didaktike përmbajnë një vlerësim, vlerësimi vetë përcakton pedagogjinë. Të reflektosh mbi vlerësimin në përgjithësi do të thotë të rimendosh objektivat e mësimdhënies, strategjitë e adoptuara në pedagogji, pritshmëritë e shkollës kundrejt klasave si dhe nxënësit në veçanti. Kështu pra vlerësimi është një mjet rregullues gjatë mësimdhënies dhe ndikon në përmirësimin e formimit të nxënësit si dhe në fleksibilitetin e hapjen në programimin e njësive didaktike. Në shkollën e mesme theksi vihet në verifikimin e aftësive mbi bazën e objektivave dhe pritshmërive të shpjeguara mëse qartë për nxënësit. Mësimdhënia e elementëve gjuhësorë duhet të mbështetet tek përcaktorët gjuhësorë të Kuadrit të përbashkët të referencës për gjuhët.

Vlera e këtij dokumenti është e lidhur me nivelet që përkufizojnë shkallët e progresive të të nxënurit si dhe kompetencat e ndryshme gjuhësore. Ata mund të përdoren si përshkrues të prodhimit të nxënësve, por edhe si objektiva formues të cilëve mund t'u referohesh si dhe si mjete vlerësimi apo vetëvlerësimi.

Idealisht vetvlerësimi i nxënësit dhe vlerësimi i mësuesit duhet të përputhen:

- vetëvlerësimi i nxënësit dëshmon aftësinë e tij për të reflektuar mbi njohuritë, aftësitë dhe atë që është në gjendje të japë,



- vlerësimi nga ana e mësuesit jepet si një masë e jashtme e objektivë mbi këto njohuri, aftësi e prodhueshmëri.

Vlerësimi do të bëhet si me shkrim ashtu edhe me gojë, në bazë të programit të shpërndarjes së orëve mësimore, të llojeve të ndryshme si pyetësorë me pyetje të hapura apo teste me alternativa për të nxjerrë në pah njohuritë e nxënësit mbi elementët morfologjikë e sintaksorë, si dhe ndërhyrje në mësimë interaktive me anë të projekteve të ndryshme që do të trajtohen në këto orë. Gjithashtu vlerësimi do të bazohet edhe mbi ushtrime individuale apo grupi.

Përgjithësisht do të jenë 4 provime të shkruara vjetore dhe po aq gojore.

### **Kriteret e vlerësimi**

Vlerësimi do të jetë me notë nga nota 4 deri në 10, bazuar në sistemin e vlerësimit të vendosur nga MASH DHE AVA dhe do të bazohet tek këta tregues:

*për vlerësimet me gojë:*

- përvetësim dhe saktësi i prodhueshmërisë
- kontrolli mbi njohuritë e përfutuara
- aftësi përpunimi dhe përmbledhjeje të materialeve njohja/ zotërimi i elementëve të caktuar
- aftësi ekspozuese të testuara (analizim, interpretim, kontestualizim, etj)
- aftësi ekspozuese dhe përdorim të gjuhëve specifike
- aftësi përmbledhëse

*për vlerësimet me shkrim:*

- realizimi gjuhësor
- koherenca dhe përshtatja me detyrat dhe format e ndryshme tekstuale’
- kontrolli mbi njohuritë e përfutuara
- aftësim i përgjithshëm duke u bazuar tek origjinaliteti, aftësia kritike e përmbledhja si dhe tek frytshmëria e tekstit.

Këto parametra që përmban kurrikula, mund të artikuloen në brendësinë e tyre, nëse është e mundur me llojin e testimit, duke i dhënë më rëndësi herë pas here treguesit më të rëndësishëm. Në veçanti parametri i realizimit gjuhësor mund të detajohet me saktësi, në mënyrë që të nxjerrë në pah dhe të marrë në konsideratë të gjithë treguesit që hynë në këtë kontekst (saktësia ortografike, morfologjike e sintaksore; kohezioni i tekstit, saktësia leksikore, përdorimi i regjistrit, etj). Parametri i sipërpërmendur mund të ketë, duke i ardhur në ndihmë vlerësimit, një “peshë” të madhe .

### **Sa shpesh dhe si mund të realizohet vlerësimi.**

Përgjatë zhvillimit të njësive didaktike do të realizohen testime nëpërmjet ushtrimeve, përmbledhjeve, analizave të teksteve, prodhimeve të teksteve, debateve, ndërhyrjeve dhe ngritjes në mësim. Në përfundim të njësisë apo njësive do të zhvillohen prova të llojeve të ndryshme, në bazë të argumenteve të trajtuar (përmbledhje, analiza teksti, ushtrime, prova gjysëm të strukturuar )

Për prodhimin me gojë, parashikohen këto lloj testesh:

- përgjigje me gojë
- marrja pjesë në argumente të caktuara
- marrja pjesë në leksione interaktive (analizë/interpretim teksti) apo në përfundim të mësimëve frontale.

Për prodhimin me shkrim, parashikohen:

- një minimum prej katër provash vjetore (analiza teksti, ese të shkurtra, artikuj gazetash, tema aktualiteti/historie)
- prova të ndryshme me shkrim si detyra shtëpie për të cilat do të jepet një vlerësim me qëllim orientues.

Parashikohet mbështetja tek pyetësorët e strukturuar apo gjysëm të strukturuar me vlerë përfshirëse në provat me gojë.

Për të stimuluar thellimin e disa aspekteve të caktuara, parashikohet organizimi i punëve më të thelluara nga ana e nxënësit, individualisht apo në grupe.

Tregues për vlerësimin final të lëndës janë:

- a)interesi dhe pjesëmarrja e nxënësit gjatë vitit shkollor
- b)zotërim/ aftësi i njësive didaktike dhe elementëve të tyre
- c)aftësitë e veçanta (të fiksuara në bazë të objektivave të programit mësimor)
- d)aftësitë gjuhësore dhe komunikuese.

## **VETËVLERËSIMI**

Është një element tjetër i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës italiane, ku secili jep gjykimin për aftësitë e veta. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojë sa më mirë të nxëniet e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi ashtu edhe mësuesi.

Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grup-moshën e tyre dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian Gjuhëve(PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurikulare etj.

PEGJ është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGJ e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGJ kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

